



Pranuar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Delivered	18.11.2020	0	viti god year
Organ /Njesia Org./Jednotica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSTICK	2644/2020		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.304/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë dhe Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.304/2020 të datës 13.10.2020 të parashtruar nga ankuesi ██████████, me adresë banimi në fshatin Polac, Komuna e Skenderajt, kundër organit të punësimit Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.304/2020 të datës 13.10.2020 të parashtruar nga ankuesi ██████████.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesi ██████████ i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 23.07.2013 në pozitën e punës "Vozitës" në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, tani e riorganizuar në kuadër të Ministrisë për Ekonomi dhe Ambient, më datë 09.03.2020 dhe 05.08.2020, ka parashtruar tek organi i punësimit kërkesë për shqyrtim-rritje të koeficientit të pagës.

Ankuesi, meqenëse nuk ka marr përgjigje nga organi i punësimit-Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, më datë 13.10.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 2078/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.10.2020, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, ndërsa ky fundit më

datë 29.10.2020 ka përcjell përgjigjen në ankesë duke bashkangjitur edhe provat ndërlidhur me lëndën.

Administrimi i provave: Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesë ka administruar këto prova: Ankesën e datës 13.10.2020 me numër protokollit 2078/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 2215/2020 të datës 22.10.2020; Autorizim i datës 13.10.2020; Akt Emërimi i datës 23.07.2013; Kërkesë për shqyrtim (rritje) të koeficientit i datës 05.08.2020; Përgjigje rreth kërkesës i datës 23.06.2020; Kërkesë për shqyrtim të koeficientit i datës 09.03.2020; Akt Emërimi i datës 07.08.2012; Akt Emërimi i datës 03.03.2014; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 12.02.2015; Akt Vendim i datës 18.05.2018; Përgjigje në ankesë e datës 29.10.2020; Autorizim i shpalljes së konkursit publik/Ministria e Zhvillimit Ekonomik i datës 22.05.2013; Kërkesë për aprovimin e nisjes së rekrutimit i datës 16.05.2013; Kërkesë për fillimin e rekrutimit (punësimit) i datës 15.05.2013; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 27.11.2012; Miratimi i titujve të ri të punës për Ministrinë e Energjisë dhe Minierave Prishtinë i datës 04.02.2005; Akt Emërimi i datës 15.03.2012.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të dërguara nga palët, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi [REDACTED] [REDACTED], *sepse*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke iu referuar provave të lëndës respektivisht Akt Emërimit të datës 23.07.2013, konstaton se ankuesi mbanë pozitën e punës "Vozitës" në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 paragrafi 6 përcakton se: *Nëpunës administrativo-teknik-dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike.* Bazuar në këto dispozita ligjore, e duke marr parasysh se ankuesi mban pozitën e Vozitësit, Kolegji vlerëson se i njëjti ka statusin e nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, dhe si rrjedhojë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit me status administrativo-teknik dhe mbështetës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave vlerëson se edhe me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën e themelimit të marrëdhënies së punës të ankuesit, përkatësisht neni 4 paragrafi 4 ka përjashtuar personelin mbështetës nga Shërbimi Civil, duke përcaktuar se: *Personeli i punësuar nga institucionet e administratës në nivel qendror dhe komunal, përgjegjës për kryerjen e funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes, nuk janë nëpunës civilë.* Sipas kësaj Ministria e Administratës Publike me datë 08.12.2014, ka nxjerr Qarkoren Administrative, e cila ka përcaktuar se pozita e vozitësit hynë në kuadër të pozitave të punës me funksione mbështetës, dhe ka udhëzuar institucionet publike që marrëdhënia e tyre e punës të rregullohet sipas dispozitave të Ligjit të Punës.

Bazuar nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatet për pranim në Shërbimin civil, siç është përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nen paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet së: *Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.*

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.304/2020

Çlirim Zeka

Çlirim Zeka
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-Demi

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit [REDACTED]
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.